

FEDERATA E MUNDJES SË KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: R.R. "AGIM RAMADANIP" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

Bordi i FMK-së në bazë të nenit 41 paragrafi 12 pika (i) të Statutit të Federatës së Mundjes të Kosovës, në mbledhjen e vetë të mbajtur 06.10.2022 miratojë:

ORGANIZIMI I GARAVE NË MUNDJE


1 Garat në sistemin e FMK-se

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Nëse një klub dëshiron të organizojë gara nën ombrellën e FMK-se duhet të jetë anëtar i rregullt i FMK-se, duhet të paraqesë dëshminë që ka siguruar objektin dhe kushtet për organizimin e aktiviteteve sportive . Klubi që dëshiron të organizoi gara nga kalendari i FMK-se duhet të jetë i licencuar nga FMK në vitin paraprak.
2. Të gjitha garat duhet të janë në kalendarin e garave të Federatës se Mundjes të Kosovës. Organizatorët e mundshëm duhet të aplikojnë në FMK për organizimin e ndonjë gare. Aplikimi duhet të bëhet para se FMK të bëjë publik kalendarin final për vitin vijues. Për të përfshirë në kalendar ndonjë garë pas publikimit të kalendarit final të garave nga FMK, organizatori duhet që këtë ta kërkoj nga FMK së paku 30 ditë para garës.
3. Të gjitha garat në nivel të qytetit - komunës, rajonit dhe shtetit organizohen sipas rregullave të FMK-se respektivisht dispozitave të këtyre rregullave.
4. Shpjegues (interpretues) i këtyre propozicioneve (rregullave) është Bordi i FMK-se, kurse në vet garën është delegati i garës.
5. Të drejtë të pjesëmarrjes në garat e lartcekura kanë anëtarët e:
 - klubeve të mundjes të regjistruara në FMK,
6. Dëshmia e anëtarësimit në garat e mësipërme dokumentohet me regjistrimin në databazë ose me librezën garuese të FMK të vërtetuar për vitin aktual.
7. Zyra e FMK-se mban evidencë për të gjithë garuesit-et të cilët kanë marrë pjesë në garat zyrtare në Kosovë. Nëse vërtetohet se në një garë individuale, ka marrë pjesë garuesi-ja për ndonjë arsy që nuk ka pasur të drejtë pjesëmarrje, rezultati i tij duhet të shlyhet (fshihet), kurse garuesi-ja dënohet me dispozitat disciplinore për këtë lloj të veprës. Pas kalimit të afatit për paraqitje, zyra e FMK-se do të verifikoi nëse paraqitjet janë bërë në afatin e paraparë dhe në lidhje me këtë do ta njoftoi delegatin e FMK-se për atë garë.

1.1.2 GARAT (Thirrjet për organizim të garave)

1. Thirrje për caktimin e organizatorëve të garave në nivel kombëtar për gara të veçanta e shpall zyra e FMK-se para miratimit të kalendarit të garave.
2. Klubi konkuries mund të marrë organizimin e ndonjë gare vetëm me propozimin dhe miratimin nga Bordi i FMK-se. Përfshirja në kalendarin e garave është e mundur vetëm sipas kushteve të përcaktuara. Rezultatet bëhen valide vetëm nëse janë përfillur të gjitha rregullat dhe propozitionet.



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADAN" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

3. Organizatori i mundshëm duhet që gjatë aplikimit në thirrje të garantoj përbushjen e kushteve të këtyre rregullave dhe propozacioneve, të cilat janë :

- Tapetin (dyshekun) e mundjes,
- Peshoren per peshimin e garuesve.
- Tavolin te punes per delegat dhe gjyqtaret
- zërim për ambientin e garës,
- semafor (tregues të rezultatit) në vendngjarje,
- mjekun dhe autoambulancen.

4. Gjatë aplikimit në thirrje organizatori i mundshëm (potencial) duhet të përshkruajnë mundësitë dhe kushtet për akomodim, eventualisht edhe kushtet e transportit. Gjithashtu mund të bëjë me dije përfitime të veçanta, të tilla si shpërblimet për fituesit, individët për rezultatin më të mirë të arritur, drekën ose darkën e përbashkët etj.

Organizatori me aplikimin e tij merr përsipër që të bartë të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të organizimit. Kriteret për të marrë vendimin për organizim të garës në nivel shtetëror janë (renditja sipas vlerës së kritereve):

- nota e organizimit të vitit paraprak
- ofertat speciale të organizatorit

5. Në palestra , organizatori duhet të kërkojë pëlqimin e drejtuesve të palestres për garat në të cilat ka aplikuar.

7. Vendimin për kontraktim të organizatës (klubit) e bie bordi i FMK-se me propozim të komisionit (delegatit) të garave.


8. Ne keto gara do të gjykojnë gjyqtarët e licensuar nga FMK dhe United World Wrestling.

1.1.3 ORARET DHE FILLIMET E GARËS

1. Organizatori duhet t'i përbahet orarit në përputhje me rregulloret (propozacionet). Në rastin e shkaqeve të arsyeshme, organizatori mund të bëj një propozim që shpjegon arsyet e ndryshimit të administratës së FMK-se dhe këtë me aprovim, të paktën 7 ditë para garës. Në rast të miratimit të ndryshimit, organizatori është i obliguar që me shpenzimet e tij të informoj të gjitha ekipet – pjesëmarrëse për ndryshimin e orarit të paktën 5 ditë para garës.
2. Të gjitha kampionatet dhe turnet peshimi duhet të zhvillohen paradite(10-10.30), ndersa garat do fillojen pas dite(12.00).
3. Organizatori mund të propozojë ndryshime të vogla në orar, në qoftëse përmirësojnë ritmin e garës,, apo ndonjë arsyet tjetër të ligjshme. Këto propozime duhet të dorëzohen në FMK, por edhe Delegatit të FMK-se më së voni para fillimit të takimit teknik.
4. Ndryshimet e aprovuara të orarit duhet të vendosen në takimin teknik dhe duhet t'i jepet çdo gjyqtari - klubit dhe të reklamohet për pjesëmarrësit.

1.1.4 PARAQITJET

1. Klubet pjesëmarrëse janë të obliguara që 3 ditë para garës (p.sh. nëse gara fillon të shtunën, afati i fundit për paraqitje është e mëkurë deri në orën 24), ekskuluzivisht me postë elektronike (e-mail), në formularin e përcaktuar nga FMK të bëjnë paraqitjen e garuesve të tyre për pjesëmarrje në garë. Në kërkësë të aplikimit klubet detyrohen t'i zbatojnë kufizimet e kategorive sipas rregullores se garave te FMK-se.
2. Pas skadimit të afatit për paraqitje, zyra e FMK-se duhet që t'i përcjellë të gjitha parashtresat për pjesëmarrje tek organizatori.
3. Organizatori nuk duhet të pranoi kërkesa tjera për paraqitje përvëç atyre të pranuara nga FMK.
4. Askush nuk mund, duke përfshirë edhe mikpritësit, për të dorëzuar paraqitjen me vonesë, përvëç asaj që i është



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: R.R. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00 381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

dërguar me kohë FMK.

5. Paraqitja e mundesav-e jashtë konkurrence duhet të bëhet duke përdorur formularin e FMK- dhe një kopje e paraqitjes duhet të dërgohet edhe në zyrat e FMK-se.
6. Në takimin teknik duhet që organizatorit ti vërtetohet lista e pjesëmarresve .

1.1.5 SHTYRJA DHE ANULIMI I GARËS

1. Garat sipas këtyre rregullave do të mbahen në datat e parashikuara të kalendarit të garave.
2. Për shtyrje (ndryshim të datës) apo anulim të organizimit të garës, organizatori është i obliguar që t'i drejtohet zyrës së FMK-se me kërkesën në kohën e duhur (së paku 3 javë para garës) me arsyetim.
3. Zyra e FMK-se për vendimin e saj duhet të njoftoj të gjithë pjesëmarrësit e garës. Vendimi do të përfshijë një datë të re dhe titullin e organizatorit të ri eventual.
4. Në rast se ndodhë ndonjë incident si pasojë e fuqisë madhore apo incidenti tjetër kritik pak para apo gjatë garës delegati i FMK-se mund të ndërpres ose të shtyjë garën për një ditë ose për një periudhë të pacaktuar. Vendimin për datën pasuese të garës e merr zyra e FMK-se.

1.1.6 MEDALJET DHE SHPËRBLIMET

1. Titullin e kampionit shtetëror e fiton dhe i jepet medalje vetëm në qoftë se ne kategori kanë marrë pjesë së paku tre garues-e.
2. Nëse në një kategori të veçantë të kampionatit të Kosovës ka më pak se tre garues-e, mundet, por jo më vonë se gjatë takimit teknik të lejohen paraqitje shtesë por vetëm nga ata mundes-e të cilët janë paraqitur me kohë për atë garë. Mundesi-ja i cili është i vetëm në një kategori mund ta ndërroj kategorin për të garuar në një konkurençë tjetër.
3. Lejohet pjesëmarrja e së paku dy garuesve, kurse fituesi është më i miri në këtë kategori pa deklaruar (pa shpallur) fituesin dhe dhënien e medaljes.
4. Dekoratat zyrtare, medaljet dhe trofetë jepen nga FMK- si vijon:
 - kampionatet individuale (të gjitha kategoritë): medaljet për tri vendete e para.
 - kupat (të gjitha kategoritë): Kupat për tre ekipe të renditura ne vendete e para.
 - Turne, medalje per tre të parët ne te gjitha kategorit, kupa per mundesin me te mire, teknikun dhe mundesin me te mire nga jashte.


Rekomandohet që organizatori fituesve t'u ndaj shpërblime, dhurata apo çmime financiare nga sponsorët e tij.

1.2 Detyrat e organizatorit

1.2.1 NJOFTIMET NGA ORGANIZATORI

Organizatori i Kampionatit shtetëror, tureneve mbarkombetar dhe nderkombetar ka për detyrë të paktën 7 ditë para garës të gjithë pjesëmarrësve t'ju bëjë një njoftim që përmban informacionin e mëposhtëm:

- titullin dhe adresën e organizatorit, numrin e telefonit dhe e-mail-in.
- emri i personit përgjegjës për kontakt dhe informacion,
- kategorit e peshave,
- vendi, palestra, dafa dhe koha e fillimit të garës,
- vendi dhe koha e peshimit dhe takimit teknik,
- orari,
- afati i fundit i aplikimit (paraqitjes),
- përshkrim i aplikimit (lokacionin, përshkrimi i detyrave dhe të ngjashme),



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

- shpërblime të veçanta (eventuale),
- kushtet e akomodimit (karakteristikat, çmimet)
- kushtet e ardhjes dhe largimit (eventuale),
- informacione të tjera të dobishme.

Organizatori është i obliguar të paktën pesë ditë para garës që të informoj mediat (gazeta, TV, radio rrjete sociale dhe portale) për garën (lojin e garës, vendin, kohëne fillimit dhe orarin). Organizatori duhet të informojë FMK-n të paktën tri ditë para mbajtjes së garës për datën e ndryshimit eventual (e shtunë - e diel) me arsyetim për shkak të fuqisë madhore.

1.2.2 MBLEDHJA TEKNIKE

1. Organizatori duhet të sigurojë një dhomë (hapësirë) dhe të organizojë një mbledhje teknike të paktën një orë e gjysmë (90 minuta) para fillimit të programi. Në mbledhjen teknike duhet të jetë i pranishëm gjyqtarët dhe delegati.
2. Mbledhja teknike është e detyrueshëm për të gjitha klubet pjesëmarrëse të garës.
3. Të gjitha vendimet e marra në mbledhjen teknike janë të detyrueshme për të gjitha klubet dhe pjesëmarrësit

Prishtine
06.10.2022

